

VENDIM
Nr.607, datë 31.8.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.158, DATË 22.3.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR STRUKTURËN, ORGANIKËN DHE NIVELIN E PAGAVE TË
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 24, të ligjit nr.8502, datë 30.6.1999, “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare” të ndryshuar dhe të neneve 124 e 128, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.158, datë 22.3.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:


1. Në pikën 1, lidhjet nr.I dhe nr.II zëvendësohen me lidhjet I dhe II, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kategorizimi i pozicioneve “Përgjegjës sektori”, “Specialist” dhe “Korrektor”, sipas kolonës “Kategoria e Pagës”, të Lidhjes II, “Organika e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, të zbatohet duke filluar nga data 1 korrik 2006, në përputhje me përcaktimin e vendimit nr.407, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve në varësi të ministrave të linjës”.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA I
ORGANIGRAMA E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE
19



LIDHJA II

ORGANIKA E QENDRES SE PUBLIKIMEVE ZYRTARE

POZICIONI	KATEGORIA E PAGES	NUMRI
I. DREJTOR		1
Kryeredaktor		1
II. SEKTORI I FLETORES ZYRTARE		(7)
PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
REDAKTOR		1
KORREKTOR	IV-a	2
OPERATOR		3
III. SEKTORI I BOTIMEVE TE TJERA		(5)
PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
INFORMATICIEN		1
KORREKTOR	IV-a	1
OPERATOR		1
SPECIALIST (ARKIVI)	IV-b	1
IV. SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE		(5)
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST (PER MARKETINGUN)	IV-b	1
MAGAZINIER		1
SHOFER		1
PUNETOR PASTRIMI (PASTRUES)		1
PUNONJES GJITHSEJ		19